



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.74/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afiete Sada-Gllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Arta Krasniqi, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e palejuar apeli Anr.74/2019. i datës 20.09.2019, e parashtruar nga Arta Krasniqi, me të cilën kërkon që bashkëshorti i saj të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Arta Krasniqi, në të cilën pretendohet se Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ia ka refuzuar bashkëshortit të saj, të saj përfshirjen në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Në përgjigjen në apel të datës 20.09.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) thekson se parashtruesi i ankesës gjatë periudhës së aplikimit ka dërguar aplikacionin për regjistrim së bashku me kopjen e një dokumenti të huaj. Me këtë rast, ky person ka dëshmuar vetëm identitetin, por nuk ka dëshmuar apo nuk ka dërguar ndonjë kopje të dokumentit me të cilin do të plotësohej njëra nga kushtet ligjore, për t'u përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e palejuar

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Arta Krasniqi është i pa lejuar, sepse parashtruesja e apelit nuk ka poseduar autorizim për të paraqitur apel në emër të bashkëshortit të saj dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standartet e kërkuara sipas

Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6 ku përcaktohet se: *Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga personi i autorizuar.*

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e lartëtheksuar.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 74/2019 më datën 22.09.2019.

**Kryesuese e Panelit**  
**Faton Ademi**



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*